



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 41 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-40, nenit 2.1 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, dhe nenit 35 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 18 janar 2018, miratoi këtë:

### **VENDIM**

### **PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

Fatmir Gashi, prof. i Mbrojtjes dhe Siguri, nga fshati Dobërdol, Komuna e Podujevës, zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

#### **Neni 2**

Kryesuesi fillon me ushtrimin e funksionit menjëherë, dhe mandati i tij ndërlidhet dhe është në kohëzgjatje të njëjtë me mandatin e Kuvendit.

#### **Neni 3**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe aktet nënligjore të Nivelit Qendror dhe ato të Komunës.

#### **Neni 4**

Kryesuesit, për punët dhe angazhimet në kuadër të fushëveprimtarisë së Kuvendit, i bëhet kompensimi konform legjislacionit përkatës në fuqi.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-060/0004490/18**  
**Podujevë,**  
**18 janar 2018**

Kryesuesi i mbledhjes  
**Mehmet Gashi**